

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Rafete Suli, në lëndën penale kundër të pandehurit B.H. nga ..., Rr.e ... nr. ..., ..., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.2176/17 të datës 24.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datën 01.08.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.H. nga babai Sh. dhe nëna M., i lindur më data e lindjes..., në ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, i arsimuar, ka të përfunduar shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprën penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 30.10.2017, në kohë të papërcaktuar, në lokalitetin e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe të paautorizuar ka përfituar nga shërbimi komunal-rrjeti i shpërndarjes së rrymës së ...-it, në atë mënyrë që pas çkyqjes është lidhur direkt në rrjet jashtë njehsorit elektrik, ka shpenzuar energji elektrike pa u regjistruar ajo askund si shpenzim, me ç'rast ...-in Distriktin në ... e ka dëmtuar për shumën e të hollave në vlerë prej 1.990,66 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 41, 42, 45, 46, 47, 50,51 dhe 52, 73,74, 75, 76 KPRK-së si dhe nenit 365 KPP-së,

G J Y K O N

I.ME DËNIM KUMULATIV ashtu që të pandehurit do ti shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300(treqind) euro, të cilën i akuzuari do ta paguaj menjëherë me plotfuqishmërinë e aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, ashtu që çdo ditë do të llogaritet nga 20 euro.

II.Të pandehuri i shqiptohet dënimi me kusht në kohëzgjatje prej tre muajve, ashtu që ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale në cilin rast dënimi me kusht do të revokohet.

III.I dëmtuara ... për realizimin e kërkesës pronësore – juridike është udhëzuar në kontestin civil.

IV. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 20 euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

V. Në përputhje me nenin 39 paragrafin 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i pandehuri obligohet që në emër të taksave për kompensimin e viktimave të paguaj taksën prej 30 euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B.H. nga ..., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së. dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur me datë 01.08.2018, ku është lexuar aktakuza nga Pokurori i Shtetit PP.nr.2176/17 e datës 24.11.2017 dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale me të cilën ngarkohet, duke shtuar që e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Në mbrojtjen e tij ka cekur që ai nuk jeton në atë shtëpi, që ka pas qiragji që e kanë bërë atë hargjim, mirëpo i pandehuri e pranon në emër të tij pasi që nuk ka mundur ta gjej qiragjijun, e kur e ka gjet ai nuk ka dashtë ta pranoj borxhin.

I pandehuri në tërësi e pranon borxhin si të vetin dhe do ti propozoj ...-it që borxhin ta paguaj në dhjetë këste mujore, që do të thotë çdo muaj nga 200 euro dhe prandaj lut gjykatm që ta dënojë me një dënim më të butë.

Në shqyrtimin e parë publik gjyqtarja individuale ka marr aktvendim me të cilën është pranuar pranimi i fajësisë, pasi që është konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjyqtari individual ka konstatuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, që pranimi i fajësisë bazohet në faktet lëndore të cilat i përmban aktakuza dhe që aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore sa i përket fakteve.

Konform këtyre, gjyqtarja e vetme ka vërtetuar gjendjen faktike në vijim:

-që i pandehuri e ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së. në kohën, vendin dhe mënyrën të përshkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 320 KPRK-së parasheh që çdo person që merr, shfrytëzon, nxjerr ose shfrytëzon çfarëdo shërbimi komunal, me të cilën furnizohet nga rrjeti elektroenergjetik ose rrjetit distrikt pa autorizim të furnizuesit të autorizuari, do të dënohet me dënim me gjobë dhe dënim me burg në kohëzgjatje deri në tri vite.

Në bazë të gjitha të dhënave gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpallë fajtor për kryerjen veprës penale pasi që veprimet e të njëjtit përmbajnë elemente të kësaj vepre penale dhe për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës gjatë shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit gjyqtarja individuale ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata për të pandehurin ka marr që e ka pranuar fajësinë për veprën penale, që deri më tani nuk ka qenë i gjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, që ka pranuar që të kryej obligimet e borxhit ndaj ...-it, dhe që edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas besimit të gjyqtares së vetme dënimi kumulativ i shqiptuar ndaj të pandehurit paraqet dënimin që është i drejtë në përputhje me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme konstatoi që edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.1268/17 me datë 01.08.2018

Sekretarja juridike,

Rafete Suli

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu:
Ardijana Aliu